Kronikë

500 gr tritol vilës në Kurbin, mbi 10 persona të shoqëruar! Kamerat e sigurisë në banesë jashtë funksionit, ende asnjë gjurmë të autorëve

Mbi 10 persona janë shoqëruar dhe marrë në pyetje nga Policia e Kurbinit në lidhje shpërthimin e ndodhur në banesën 3 katëshe të familjes Lika në fshatin Sanxhak, por ende nuk është arritur të bihet në gjurmët e autorve të ngjarjes.

- VIDEO/Tritol vilës së Skënder Likës, gjendet e djegur makina e autorëve në Gramëz të Fushë-Krujës
- Shpërthim i fuqishëm në Laç/ I vihet tritol banesës së Skënder Likës, djali i tij në 2021 vrau biznesmenin Rakip Roli! Dëmtohen edhe banesat përreth (VIDEO)

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Gjeniuthun

Elvis Hila
11 Mars, 09:18 | **Përditësimi: 11 Mars, 13:21**

Mbi 10 persona janë shoqëruar dhe marrë në pyetje nga Policia e Kurbinit në lidhje shpërthimin e ndodhur në banesën ***3 katëshe të familjes Lika*** në fshatin Sanxhak, por ende nuk është arritur të bihet në gjurmët e autorëve të ngjarjes.

Mes personave që kanë dhënë dëshminë e tyre në policie janë dhe pjesëtarë të familjeve me të cilët kanë hasmëri familja që ishte objektiv i sulmit, por kanë mohuar të kenë lidhje me vendosjen e lëndës shpërthyese dhe janë lënë sërish të lirë. Në pjesën e përparme të banesës tre katëshe, ka patur kamera sigurie, por sipas burimeve nga grupi hetimor kanë qenë jashtë funksioni.

[Sh.COM]
LEXO EDHE:
Shembet ura në Berzane të Lezhës, 6 familje të izoluara: Të ndërhyhet me urgjencë, s'kemi ku të kalojmë

Policia ka sekuestruar dhe po analizon kamerat e disa banesave dhe bizneseve në zonë, por nga kqyrjet e deritanishme të pamjeve asnjëra prej tyre nuk i ka fokusuar lëvizjet e autoreve që mendohet të kenë qenë më shumë se 2 persona.

Ndërkohë nuk është përcaktuar sasia dhe lloji i lëndës plasëse, por referuar forcës së shpërthimit dhe dëmeve që ka shkaktuar mendohet të ketë qenë rreth 500 gram. Ngjarja ndodhi rreth orës 3 e 30 minuta të mëngjesit të së premtes në fshatin Sanxhak të Kurbinit dhe objekt i sulmit me lëndë plasëse ishte banesa e Skënder Likës.

Ndërkohë një autoveture tip 'Volkswagen Passat' është gjetur e djegur nga policia ne vendin e quajtur Kallamat në fshatin Gramës të Fushë-Krujës. Autovetura dyshohet të jetë përdorur nga autorët për vënien e sasisë së eksplozivit familjes Lika në Laç. Pritet të vijnë ekspertet nga Laçi për të bërë kqyrjen e mjetit

Shpërthimi ishte i fortë duke shkaktuar dëme të shumta materiale dhe në objekte të tjera aty pranë, por fatmirësisht nuk pati persona të lënduar. Pista kryesore e hetimeve është përqendruar tek hasmëria, pasi Skënder Lika, është babai i autorit të vrasjes së biznesmenit Rakip Roli. Ndërkohë dhe nipi i tij, Ilir Lika është dënuar nga gjykata si bashkëpunëtor i në vrasjen dy biznesmenëve, Paulin Gjergji dhe Bujar Lika, ngjarja e ndodhur brenda një lokali në Kurbin në vitin 2020.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 10:01

VIDEO/Tritol vilës së Skënder Likës, gjendet e djegur makina e autorëve në Gramëz të Fushë-Krujës

Një autoveture tip 'Volkswagen Passat' është gjetur e djegur nga policia ne venin e quajtur Kallamat në fshatin Gramës të Fushë-Krujës.

Autovetura është shkrumbuar totalisht nga flakët dhe për të nuk ka patur njoftim ne sallën operative, por mjeti është gjetur i djegur totalisht dhe është dërguar në komisariatin e policisë në Krujë. Autovetura dyshohet të jetë përdorur nga autorët për vënien e sasisë së eksplozivit familjes Lika në Laç. Pritet të vijnë ekspertet nga Laçi për të bërë kqyrjen e mjetit

Nuk dihet se kujt i përket mjeti apo nëse brenda tij ka prova apo materiale që do të ndihmojnë për identifikimin e autorëve. Duhet theksuar se zona e Kallamave në fshatin Gramëz është përdorur prej vitesh nga kriminelë të ndryshëm për të djegur autoveturat që përdorin për krime të ndryshme.

M.Q./r.k./Shqiptarja.com

TAG: Laçi Lezhë sanxhak skender lika

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
Beteja mes palëve në PD shkon në KAS, cila duhet të regjistrohet?

E Albeajt | E Berishës | Asnjëra

Lajme të tjera

Tirana fiton me Laçin dhe kthehet në krye të Superligës, Vllaznia ndal Partizanin në 'Loro Boriçi' (VIDEO)
11 Mars, 19:09

Pas sherrit për pronat në Kurbin, plagosi me armë shokun me të cilin doli për gjah! Arrestohet 56 vjeçari i shpallur në kërkim
11 Mars, 10:40

VIDEOLAJM/ Rama ndan pamje nga Laguna e Kune-Vainit: E rëndur falë masave të marra për zonat e mbrojtura, oaz i biodiversitetit
11 Mars, 08:28

Moti i keq në Lezhë, bllokohen 4 familje nga prezenca e ujit
10 Mars, 21:08

Reshjet e dendura të shiut shkaktojnë përmbytje në disa lagje të Lezhës
10 Mars, 18:54

Po kalonte rrugën për të shkuar në hotel, përplaset nga makina e mitura afgane në Shëngjin! Shoqërohet shoferja
10 Mars, 16:35

Përgjaken rrugët e vendit/ 3 aksidente me pasojë vdekjen në Durrës, Kavajë dhe Korçë! Përplasen 2 këmbësorë, shoferja 30 vjeçe përfundon në kanal
10 Mars, 12:28

Dyshohen si autor të disa vjedhjeve në Shëngjin dhe në Lezhë, në pranga 3 persona! 4 të tjerë nën hetim
10 Mars, 12:10

Moti i keq në vend, pezullohet lundrimi i mjeteve të vogla në Vlorë dhe Durrës! Reshjet e shiut shkaktojnë përmbytje në lagjet e Lezhës, bllokohen 4 familje
10 Mars, 11:55

'Derbi i përket së shkuarës', Orges Shehi tregon frikën e Tiranës: Ky lojtar mund të mbyllë sezonin
10 Mars, 10:40

Shpërthim i fuqishëm në Laç/ I vihet tritol banesës së Skënder Likës, djali i tij në 2021 vrau biznesmenin Rakip Roli! Dëmtohen edhe banesat përreth (VIDEO)
Elvis Hila
10 Mars, 07:18

8 marsi i Rudinës, rrit fëmijët me punën në lulishten e Lezhës
8 Mars, 19:53

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje